

8 JH - 1

N. BULKA

B 92



20  
6

191-200

IV e dritën e yllit

~~8P1.983-1~~

~~11339~~

~~B 92~~

~~15~~

~~8A-A~~

~~Bul 92~~

N. BULKA

DIV. GJIROKÄSTER LIBRARY

*11685*

# NE DRITEN E YLLIT



Shtëpija Botonjëse «Naim Frashëri»

Tiranë, 1952

## MUJO ULQINAKU

Ç'janë ata që nxijnë detin ?  
Nëno ! E dëgjon tërmetin ?

— Jan hordhitë e dushmanit,  
Që t'i vënë zjarr vatanit  
O biro !

— Ç'jan ata këmishë - zesë,  
Që po vinë aq serbes,  
Me ca pupla si këndes  
O nëna ime ?

Ata janë mizorira  
Që po vinë me zinxhira,  
Të na lidhin këmb' e kokë,  
E ta bëjnë var e gropë,  
Çdo luath, çdo fush e pyll  
Do nxirosinë çdo yll !  
Pa do mbushin me kuçoma,  
Me kuçoma, ah të njoma  
Çdo kodrin e çdo hendek  
Mal më ma! e brek më brek.  
— Zjarr nga deti, zjarr nga qjelli ;  
Nëno u sterrua dielli !

— Durrës ty o Durrës plak,  
Hasmi po tē shkel nē prak !  
Populli u mbyt nē gjak.  
Çpo lëfton një ulqinak.  
Lëfton djali, lëfton plaku  
Gjer nē gju na vate gjaku,  
Bjeri Mujo Ulqinaku

Për liri.  
Lëfton populli arbreshit.  
Si dikur me pallë sheshit  
Për Shqipri.

Thrret Guzzoni: Mamma mia,  
Ç'burra paska Shqipëria !,  
Telegramet venë e vinë  
Nga Llondoni nē Athinë  
Nga Belgradi n Amerikë,  
Nga Asia nē Afrikë  
Nga Parisi gjer nē Moskë  
Çpo lëftojnë geg' e toskë  
Për një truall për një prak,  
Rrugët lahenë me gjak !

Kush lëftoń ashtu më këmbë ?  
Kush ha hekurin me dhëmbë ?  
Janë burrat shqipëtarë,  
Që po heqin zorrët zvarë !,

*Të trahtruar nga një mbret!  
Q'u degdis për në kurbet!*

*Është Mujua një kapter,  
Që lufton e vdes me nder!*

*Dhe ja plumb i mallëkuar,  
Tej-përtej në kraharuar!  
Ç na u mbyt trimi në gjak,  
Për një truall për një prak,  
Nëna me të madhe qan,  
Kur sheh shtrir' atë luan:  
— Gjirin ta kam bër' hallall  
Xhan o shpirët me yll në ballë!  
Ti m'u vrave për liri  
Ndaj të qan një Shqipëri,  
Bir o bir si lumthi ti.*

## **KÜSHTRIM NGA PEZA**

*Çka pllakosur errësira  
Vëndin tim!  
Skllavëri, kamzhik zinxhira  
Dhe mjerim!*

*Re tē zeza nga çdo anë !  
Tingëllon nér male, fusha,  
Një këmbanë.*

*Tingëllon këmban e zisë  
Çip më çip tē Shqipërisë !  
Tradhëtia po mer dhenë,  
Robëria mbyt milenë,  
Dhe pamporat nxijnë denë !*

*Ç'paska rënë hije zisë,  
Çip më çip tē Shqipërisë !*

*Vrënjtur burrat, qajnë gratë  
Zhgaba hesht në mal tē thatë..*

— *S'paska burra që t'i dalin  
Zot vatanit ?  
S'paska trima që t'i japid grusht  
Dushmanit ?*

*Kukuvajka, sorra, korba  
Fluturojnë,  
Gjer në qjej tē errësuar,  
Dhe Shqiponja zemër hekur  
Paska vdekur  
Emër - shuar ?....  
Turp e tmerr....*

*Dhe në var në fund të dheut  
Lëviz trup i Skënderbeut!*

*Ndaj rënkojnë gra e motra  
Ndër të zeza;..  
Kur një zë buçet rrufe  
Thellë nga Peza  
— Mjatt me lot, mjatt me rënkime  
Nëna ime!  
Popull ty të qołsha falë,  
Të kam at e më ke djalë!  
Erdhi koha, bura gra ta bëjmë  
Ta bëjmë fora,  
Komunisti kur e heq  
S'i shkon bosh dora!  
Se e ndrrin yll i Kremlinit,  
Se e prin fjal' e Stalinit.  
Dhe kushtimi mori dhenë!  
Zhgaba trime la tolenë!  
Dhe Partia me flamur  
Që mban në dorë,  
Yje, yje, për rreth kokës  
Një kurorë,  
Përmbi male me dëborë  
Ngjall një popull gjysmë vdekur,  
Farkëton një zëmër hekur.*

*Dhe në varr në fund të territ  
Prehen eshtrat e Skënderbeut !  
Se nër qejt tē Shqipërisë  
Po gjëmon zërt i Enverit !*

## **BRIGADAT**

*Ç'u mbush mali me petrita  
Me drangoj,  
Ndaj po oshëtin përroj.  
Thonë se po vjen tërmeti !  
Ndaj i egër shkumzon deti !  
Thonë ra rrufe nga qjelli,  
Ndaj u nxi e u zu djelli !  
Syrin flak e gjoksin zjarr .  
Po sulmon brigad'e parë !  
Dil nëno e shiko jashtë  
Si flakron brigad' e gjashë !  
Dil shiko malit përpjetë ,|  
Vetëtin brigad'e tetë !  
Prej Skrapari në Berat,  
Fluturon brigada shtatë.  
Kërcet topi anës tjatër ;  
Ububu, brigada katër !  
Ç'jan ato vetulla zes,*

*Ngjeshur bombat mu në bres?*  
*Si s'e njeh brigadën pesë?*  
*E shikon një re të zezë,*  
*Që po zbret nga trimja Pezë,*  
*Hapur gjoksat si asllanë,*  
*Qé sulmojnë mbi Tiranë?*

*Vërë re! u skuq Vijosa!*  
*Po nxin mali Trebeshinës!*  
*Pallë çveshur si fatosa*  
*U përhap kudo si zjarri*  
*Që nga Vlora e Skrapari,*  
*Labëri, Shkodër, Tiranë*  
*Korçë, Dibër, nga çdo anë,*  
*Ajka e rinisë ranë!*  
— *Bubu ç'varre pa kurora*  
*Ç'po shikoj Oh unë e gjora*  
*Bir o bir.*  
*Dhe mbi qiel të sterosur*  
*Grumbuj gjeraqina sorra!*  
— *Bir o bir!*  
*Mali bardhë me dëborë*  
*Mu mbi var u ri kurorë*  
*Dhe mbi ballë yll u ndrit;*  
*S'e shikon si llambarit?*

*Shtrëngjen dhëmbët nën e madhe  
Shqipëtare  
Mu si shqipe e egërsuar  
Dhe krenare:  
Edhe pyet e thelluar  
Në mejtim,  
Si e thonë kapedanë që i prin ?*

*Mi të gjithë mu si Ylberi,  
Komandant i prin Enveri.*

### **“PARTINË MBI TE GJITHA“**

*Po na vjen Dhjetëvjetori !  
Ç'do këndoje vjershëtori  
Q'i del atsh nga krahërori?  
Dhjetë vjet Parti - Lavdi !*

*Do këndoje popullin tënë  
Dje me njerkë, sot me nënë*

*Sot i gjallë, plot shëndet  
Ngjitem gërxheve përpjetë,  
Maja maljt gjer te retë:  
Se atje gjej trymëzime  
Ku çdo shkëmb ruan kujtime*

Ku dhe gurit i çkëputet  
Pshërëtimë prej kraharonit,  
Oh ! për gjakun e dëshmorit !  
Ku çdo shkoz' e çdo muris  
Po bën roje  
Mbi një varr të vegjëlisë —  
— Bjtë trima të partisë!  
Frymëzim kam shkrepë, pyje  
Rreth e rotull gjelbërime  
Të qëndisura me yje  
Ku ka çerdhen shqipja trime.  
Frymëzim gjej ndër lugina

Ku ka tryrë suferima  
Ku buçet Vijosa plakë  
Dhe tregon me oshëtima  
Për dragoj me tym e flakë.  
Sa përpjekje! sa beteja!  
Ku me zjarr te fush' e nderit  
Lind e thuret epopeja  
Nga fatosat e Enverit

Frymëzim gjej në Selitë  
Ku dhe nata lëshon dritë  
... Nër Uzina Kombinatë.  
— Fishkëlle me gaz sirene  
Dit'e natë

Dhe përhap si vetëtima  
Oshëtima.

Ja! shtëllunga tymi ngrihet  
Vëndi im po përtërihet  
Po sulmon njeriu i ri  
Dhe lëfton me gaz në buzë  
Çpo buçet ti, o Rinj  
Kryet lartë e synë shpuzë  
Për Enverin e për Parti

Mbi çdo gjë e mbi të gjitha  
Do këndojet si në përallë  
Trimëreshë, yll në ballë,  
Ty Parti plot me lavdi:  
Që me dritën e Kremlinit  
Dhe në gjurmat e Stalinit  
Na jepë jetë e lumtëri

### BUÇET LUMI

Pse buçet ky lum i Matit?  
Pse ushton jehona shpatit?  
Dallg' e thinjur shkumbëzon  
E gjëmon.  
Kush e di çdo ketë ngjarë!  
Kush e di ç'haber ka marë!

*U hap lajmi vetëtimë  
në Tiranë:  
— Dritë, jetë, vegjëlisë  
Anembanë!»*

*Fjal'e dalë prej Partisë,  
Buzëqesh foshnja në sisë.  
Ndaj buçet ky lum i Matit  
Kur me vrrull po zbret prej shpatit  
Po flet lumi rëndë — rëndë:  
— Gjer më dje si i tërbuar,  
«Udhëtojë i harbuar  
«Mbillnja timer përhapnja zi  
«Më mallkonte plak e i ri.  
«Një — nga — një do laj gjynahet  
«Gjithë fajet!  
«Sot e tutje tërë populli  
«Kreshnik  
«Do më quaj — «Lumë mik!»  
«Shekuj duke udhëtuar  
«Sa kam par' e kam dëgjuar..  
«Sa kujtime  
«Fsheh e ruan zemra ime!  
«Mu në der' e fukarasë  
«Pashë Vdekjen të trokasë!  
«Pranë foshnjes pa gojë  
«Pashë nënën të lotojë  
«Pashë Urinë të përgjoië:*

«Shkuan shekuj. ....  
«Shkum e verdhë e valës sime  
    «U bë gjak!  
«Kujë, vajë, shkatërrime  
    «Më çdo prak.  
«Dhe një ditë....  
«Nëpër qiej të Shqipërisë  
«Pashë dritën e Lirisë!  
«Pashë kullën e bajrakut  
    «Të rrëzohet,  
«Pashë vatrën e bonjakut  
    «Që të ngrohet!  
«Dhe atje ku Met Zogollı  
«Vartëri dhe skamje mbolli,  
«Po i jepet vëndit dritë  
«Që nga Mati në Mirditë.  
«Peshkopi e Krujë e Shkodër  
«Po ndriçohet fush' e kodër  
«Myzeqe, Fier, Berat  
«Çdo fabrikë e kombinat!  
«Sipër malesh bie borë  
    «Po s'të ngrin,  
«Ulërin tufan ndër pyje  
    «S'të mërdhin,  
    «Sot po tryn një tjetër erë  
«Dimri kthehet në Pranverë.  
«Vallë kush më jep kuvet?

„Të zgjerohem sa një det?  
„Unë plak të bëhem djatë  
„Të lëviz hydrocentralë?  
  
„Gjegjet bjeshk' e malësisë  
„Buçet zër' i vegjëlisë:  
„Ndihm' e madhe e Bashkimit  
„Sovjetik  
„Zemrën ton' e bën çelik  
„Se çeliku është Stalini,  
„Që ndrin botën nga Kremlini.  
\* \*  
Gumezhin krenare vala  
Malësis i çon të fala.

## BIR I VEGJËLISË

— Ti luan bir vegjëlie  
Ku ke qënë,  
Qindra vjet s'të ka parë  
Vëndi tënë,  
Kur errsira kish pllakosur  
Dhe kur nata s'kish të sosur,  
Mugëtirë nëpër male,  
Nëpër pyje,  
Ku as qjelli s'kishte yje?  
Ku ke qënë? •

\* \* \*

— Nëpër pranga kam jetuar,  
I munduar,  
Jo si skllav në ferr i zhytur  
Në farmak e vrer i mbytur,  
Po i gjallë, jo i vdekur  
Zemër-hekur!

Shpesh zinxhirat i kam tundur,  
Male, dete, kam lëkundur;  
Dhe si mbytesha në gjak,  
Më shkelmonte hasmi plak.

Përsëri në robëri!  
Dhe një nate të Nëntorit  
Fort të ngrirë,  
Po zvarrisesha i mpirë,

Në zinxhirë:  
Kur një shqipe sy-petrithi,  
Me dy krahë prej graniti,  
Më trokiti.

— Ngreu skllav, të erdhi dita.  
Për të verbrit zbardhi Drita!  
Jam me ty si mish e thua,  
Eja pas se më ke mual!»

«Dhe u zgjova! Dhe lëftoval  
Gjaku det, po e fitoval!  
Copë-copë u bë zinxhiri.  
**ISH PARTIA QË MË THIRI!**

\*\*\*

*Mbi një vatër të nxirosur  
 Mbi një truall të shkumbosur,  
 Mbeta zot!  
 Po kasollja e zhuritur,  
 Duhesh ngritur  
 Dhe ky vënt duhesh vaditur,  
 Jo me gjak e jo me lot,  
 Po me dwersën e të zot!  
 Ndaj tani po çaj tunela  
 e bëj malin thela-thela,  
 Thaj, këneta hap kanale  
 Ngre me vrull hidroçentrale.*

11690

\*\*\*

*Dhe kjo baltë  
 M'u bë mjaltë...*

*Se një yll më ndrin përpara  
 Mbi traktorë nëpër ara,  
 Nënë tokë në minjerë  
 Atë yll e shoh përherë:  
 Është ylli Sovjetik  
 Që më jep hov e vërtik*

\*\*\*

*Emri im? Ç'e do t'a dish?  
 Ca më thon Mehmet Dervish,  
 Ca më quajnë Allabej  
 Që çpon pusin tej për-tej,*

*Ca tē tjerë Sali Vatë  
Qē bēn malin një kafshatë!  
Dhe disa Negri Nikolla  
Qē me shokt'e tij sokola,  
Sa tē hapsh e t'mbyllësh sytë,  
E ndërton katin e dytë.*

\* \* \*

*Mija-mija ne se ç'jemi  
Veç një emër gjithë kemi  
Tingëllues...  
Unë jam LUAN SULMUES!*

## **TAKIMI VOLLSA—DON**

*Dy lumënjtë gjarpérojnë  
Njëri tjetrit drejt i shkojnë  
Duket sikur fluturojnë!  
Ja! Me vrull po përqafohen  
Kur takohen!  
I flet Vollga lehtë-lehtë,  
Donit tē qetë  
«S'po më dukesh aq i qetë  
sic tē quajnë shkrimtarë  
dhe poetë.  
I rrëmbyer, shtratin tim  
sot po sulmon  
vala jote po gjëmon—*

«— Vollga, Vollga, lum' i gjërë  
Zërin tënd shpesh e kam  
ndjerë  
kur në stepat suferina  
ulërinte,  
oshëtim' e dallgës s ate  
gjer në gjirin tim arinte!  
Namin kam se jam i qetë  
po unë eci si rrute  
siç po shkon dhe bot' e re.  
Vala ime në vrapim:  
seç këndon  
lavdi, fitim.  
Po ti Vollga si ke shkuar?»

«— Shpesh në shekujt e kaluar  
vala ime ka rënkuar  
kur me qinda mijë skllavër  
të damkosur  
mbi këto ujra zvarë, zvarë,  
gjoksat lidhur me litarë,  
në kamzhikun e tiranit  
hiqni varkat Car-Sulltanit.  
Në Totor shtatëmbëdhjetë,  
shkrepëtijnë vetëtimat  
e rrufetë!  
Jo nga qelli, jo nga retë,

*po nga tokë e zhuritur,  
vegjëlia e uritur  
ishte ngritur.  
Zbardhëdhoi! Ylli i Leninit  
llamburit!*

*Dhe nga maja e Kremlinit,  
botën ndriti.*

*Dhe për çdo pesëvjeçar  
dimëri kthehesh në behar.  
la pret Doni me habi:  
«— Është e njëjta histori,  
po e njëjta mrrekulli  
gjatë brigjeve të mi!  
Kur Lenini dha kushtrimin,  
bot' e re kundroi agimin.  
Bot' e vjetër u përmbyss  
dit' e saj u vrenjt, u ngrys.  
Tok e gjërë e vaditur,  
me lot  
shkoi në duart e të zot.  
Dhe për çdo pesëvjeçar,  
dimri kthehesh në behar.  
Kur pa pritur....  
dymbëdhjet vjet më parë  
u sulmuash nga barbaren  
Xinxhis-Hanë Timurlengë  
kapërxyer*

*Seç u nxinte mu në gjokës  
kryqi i thyer!  
Përsëri gjak e lëngatë,  
Për një kohë jo të gjatë.  
Dhe ata që kapardisur,  
Të hasdisur zbardhnin  
dhëmbët,  
Të përgjakur brekë grisur,  
Në greminë i mbajtën këmbët!  
Mbi Rajshtagon e Berlinit  
U ngrit flamur i Stalinit..»*

*Ja pret Vollga:*

*«— Edhe mua m'u átruas  
kryq i thyer, gjak përlyer,  
gjatë brigjeve të mijë,  
zgjati kokënë lubija  
Po ç'e do se ju këput  
Adolf Hitleri: kapu  
Pranë teje dorëzë armët  
Melehovi  
botës vjetër ju pre hovil!  
Pranë meje dhanë shpirt  
sa korparmata....  
Hitlerit ju thye shpata.*

---

1) Personazh reakcionar i Shellochovit në romanin „Dni i qetë”.

*Dhe tani step' e zhuritur  
 Më këto ujëra do vaditür!  
 Sa e madhe qënka forca  
 E njeriut,  
 Në kto stepat e veriut!  
 Edhe né rrugën na ndroi  
 Na bashkoi.  
 Ujërat tonë nëpër shekuj  
 do këndoijnë  
 do gjëmojnë;  
 sinfoni të pa dëgjuar  
 sinfoni të pa mbaruar  
 Dit'e madhe po aftron.  
 Ja! agimi Komunizmit  
 ZBARDHËDHON.*

### **SHKËMBI I SHQIPONJAVET<sup>1)</sup>**

*Nëpër gërxhet e Mirditës,  
 Po i hapet rrugë drithës.  
 Dhe në malet ku sundonin  
 Markagjona,  
 Shkrep më shkrep gjëmon jehona :  
 — Vullnetarë plot po dalin  
 Enver — Stalin !*

---

1) Kështu quhet nië nga shkëmbënjet më kokë-fortë të rrugës së drithës.

— “ *Hapu shkëmb, mos ha inat !*  
*Mjatt i mbajte kryet lart !*  
*Hapu se t'i derdha zorret,*  
*S' i sheh krushqit e dasmorët*  
*Që për Ulëzë po shkojnë ?*  
*Lumin venë të martojnë !*  
*Lumin do t' a nisin dhëndër,*  
*Kio s' ish parë as në ëndër !*  
*Po ti qënke kokë shkëmb,*  
*Kam vendosur të të shëmp*  
    *Shkëmb — o — shkëmb !*

*Em krenar, em i hutuar,*  
*Gjegjet shkëmbi zëmëruar :*

— *Mija vjet në këto rrëza,*  
*Plot me çerdhe për thëllëza,*  
*Shqipe malesh e skifterë*  
    *Kam sfrehuar ;*  
*Po askush nuk ka guxuar,*  
*Të më thotë — “ Luaj vëndit :*  
*Sikur t' isha pend' e shpendit !*  
*Ti dialosh me pistolet,*  
*Me kë matesh ? Kujt i flet ?*  
*Quhem shkëmbi i shqiponjës ! ”*

— *Edhe unë o Kokë — shkëmb,*  
*Jam një minator Sulmonjës !*  
*Hija jote nuk më trëmb !*  
*Dhe fitilit i flakë,*  
*Shpell e tërë u përfshak.*  
*Thellë oshëtiu lugina*  
*Po kremon ton tërë krahina,*  
*Se po hapet rrug ' e dritës ;*  
*Mes — për — mes njasaj Mirditës.*  
*Cop' e thrrime rrukulliset,*  
*Shkëmbi plak mu në luginë ;*  
*Errësira po zvarriset*  
*Në greminë.*